



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 20.6.2013, e cila filloi në orën 15:00.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, , Milazim Vitia, Tefik Mehmeti, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

**Mungoi:** Engin Beyoglu.

**Në mbledhje morën pjesë edhe** dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Dukagjin Hasimja, përfaqësues i kompanisë projektuese, "Hidroing-DK", Agim Salihu, shef i Zyres ligjore, Asdren Osaj, shef i Zyrës për marrëdhënie me publikun, drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesi i OSBE - së.

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues, duke e hapur diskutimin për rendin e dites.**

**Shemsi Veseli** propozoi që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës, që kjo pikë të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e radhës.

**Me një abstenim u miratua ky**

### **REND DITE :**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor urban për periudhën 2013 - 2022;**
- 3. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ambasadës gjermane;**
- 4. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim SHPI - KFOR-it, "Film City";**
- 5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik;**
- 6. Propozimi për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim;**
- 7. Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;**

8. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifrat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013;
9. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013;
10. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### **Pika e dytë**

**Lidhur me propozimvendimin për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor urban për periudhën 2013- 2022, Behxhet Musliu** tha se me këtë projektplan hapen rrugët ligjore për diskutim publik dhe pas një muaji na prezantohet me plotësime, sugjerime e që do të bëhet një draft përfundimtar.

**Dukagjin Hasimja**, përfaqësues i kompanisë " Hidroing DK", bëri prezantimin e këtij projektplani në mënyrë elektronike duke elaboruar disa nga komponentet kryesore të tij.

**Mustafë Krasniqi** tha se e kemi analizuar këtë projektplan dhe gjatë analizës që i kemi bërë, kemi konstatuar se ka disa gabime kryesisht rreth sipërfaqeve për hektarë, ku dallon nga ajo e kishave dhe e xhamive. Po ashtu disa vija përkufizuese mes fshatrave nuk janë të sakta etj.

**Aziz Pacolli** tha se e analizuam këtë projektplan dhe se e përkrahim që të procedohet më tutje.

**Shemsi Veseli** tha se edhe ne e përkrahim këtë projektplan por kemi disa vërejtje dhe sugjerime për të cilat vlen të theksohen. Në këtë plan nuk është dhënë asnjë fjalë rreth takimit me ekspertët e planifikimit e që është shqetësuese. Çështje tjetër është se Komiteti për urbanizëm s'e ka dhënë asnjë fjalë të ndonjë takimi rreth kësaj fushe etj. Gjithashtu për këto plane po shfrytëzohen të dhëna të gatshme, pra planet nuk po përputhen me letra , mungojnë të dhëna etj. Te pjesa grafike shihet se pak është punuar, nuk paraqet shumë lokacione të gjendjes faktike, nuk ka plan të harmonizuar etj. Te ujërat e zeza ka pak rekomandime. Po ashtu këtij plani i mungon edhe analiza e kostos së realizimit.

**Tefik Mehmeti** tha se është një material voluminoz dhe për këtë plan kemi disa vërejtje e që duhet të eliminohen pa dal në diskutim publik. Janë përshkruar objekte kulturore e në fakt aty nuk përmendet siç është p.sh, Biblioteka kombëtare etj. Jepen shifra për numrin e të papunëve, të vendbanimeve, përshkruhen disa vend parkingje me emra etj., pra janë disa gjëra që mundën me u eliminuar e që mos të përshkruhen në këtë material.

**Me plotësime dhe përmirësime, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin dhe lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit zhvillimor urban për periudhën 2013- 2022 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e tretë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ambasadës gjermane dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e katërt**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim SHPI- KFOR-it, "Film City" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e pestë**

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik, **kryesuesi** tha se në lagjen "Dardania" pjesa e parcelës që është pronë komunale është propozuar që të mbetet zonë e gjelbëruar.

**Shemsi Veseli** rreth këtij propozimvendimi ngriti shqetësim duke shtuar se këto ngastra janë në Planin rregullues të lagjes "Dardania", dhe nëse kjo parcelë është e integruar në plan, pse ta shpallim interes publik. Në çfarë forme do të bëhet kompensimi i pronarëve, dhe se aty është edhe një parking ku shfrytëzohet edhe prona komunale.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Veseli, **Behxhet Musliu** dha sqarime të nevojshme.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e gjashtë**

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, në pika të shkurtra të pranishmit i njoftoi **Agim Salihu** duke i dhënë disa sqarime të nevojshme rreth këtij propozimi.

**Shemsi Veseli** tha se këtij vendimi i mungon sqarimi i duhur, andaj propozoi që të jetë më i plotësuar.

**Me një abstenim, u konstatua se u përkrah Propozimvendimi për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e shtatë**

**Për Propozimvendimin për ndryshimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, sqarime të nevojshme dha Agim Salihu.**

**Tefik Mehmeti** bëri vërejtje për nenin II të rregullores, me ç' rast propozoi që ky nen të përmirësohet.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e tetë**

**Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013, informoi Behxhet Musliu i cili tha se më parë Kuvendi i Komunës e ka miratuar një rregullore për caktimin e taksës administrative, mirëpo ministria përkatëse nuk e ka dhënë pëlqimin që kjo të zbatohet. Andaj jemi të detyruar që t'i bëjmë disa ndryshime kryesisht rreth formës së pagesës .**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e nëntë**

**Për Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2013, Avdullah Hoti tha se janë bërë diskutimet me secilën drejtori dhe se ky rishikim kryesisht do të shkoj në shpronësime për projektet rrugore dhe në arsim.**

**Tefik Mehmeti** tha se është obligim ligjor dhe shihet se janë analizuar mirë nga ekzekutivi dhe kryesisht ky rishikim dedikohet për shpronësime, për projekte kapitale. Do të ishte mirë që për Termokos-in të parashihej një subvencion në shumën prej 500.000 € për përgatitje te sezonit të nxemjes.

**Shemsi Veseli** tha se niveli qendror po luan me dinjitetin tonë dhe se edhe ne është dashtë që të veprojmë me herët.

**Me një abstenim, u konstatua se u përkrah Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e dhjetë**

##### **Të ndryshme**

**Aziz Pacolli** ngriti një shqetësim rreth gjendjes faktike në Tauk bahqe duke cekur se në këtë hapësirë po priset gjelbërimi si pasojë e ndërtimit të parkingjeve, andaj kërkoj që për këtë çështje të merren masa.

**Shefqet Sylejmani** ngriti këto çështje:

1. Kur do të nisnin punimet në realizimin e projektit të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës ditë më parë për ndërtimin e kanalizimit fekal dhe atmosferik në lagjen "Tophane", rruga "Vushtrria" dhe "Meto Bajraktari" në gjatësi prej vetëm 150 m. dhe i ndertuar mbi 50 vite më herët, tani më i stërvjetruar i pa përbalueshëm për rritjen e kësaj lagje. Ky kanalizim është mbyllur që një muaj e gjysmë dhe ka vërshu oborret e shtëpive, për]ka kërkohet intervenim i menjëhershëm – urgjent i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe operatorve përkatës dhe i Drejtorisë së Inspektionit për sanimin e gjendjes dhe parandalimin e ndonjë epidemie.

2. Në pronësi të kujt është hapësira – oborri dhe objektet që gjenden mbrapa Bibliotekës së qytetit përkatësisht ish objekti i zhvillimit të aktiviteteve të SHKA “Bajram Curri” dhe “Gerçek” dhe tani shfrytëzohet nga një shoqatë e udhëhequr nga znj. Flora Brovina në mënyrë që kjo të ketë dedikim edhe më të gjërë dhe vendosjen e disa shoqatave ( si Shoqatës së zejtarëve, Shoqatës së grave ( më specifike) – “Jeta - Vita”, Shoqatës së artarëve dhe argjentarëve etj.)dhe institucioneve tjera të Prishtinës që janë shumë active, por pa kushte minimale materiale, teknike e hapsinore.
3. A ka leje gjegjësisht a duhet të posedohet leje për vendosjen e kamerave nga ana e personave fizik – individëve dhe afarist privat për vëzhgim në hapësirat – oborret e objekteve të banimit kolektiv, siç është rasti i një dyqangjiu në Kompleksin banesor “Dielli” në lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë, e që drejtpërdrejt i tangon banesat tona pra të z. Shemsi Veseli, z. Naser Krasniqi, Shefqet Sylajmani, z. Osman Vitija dhe të tjerëve.

**Shemsi Veseli** tha se sipas disa informacioneve thuhet se kanë filluar te jepen disa kontrata për shfrytëzimin e pronës komunale dhe ne nuk po kemi qasje ne ato dokumente, që kryesisht ka të bëjë me çështjen e parkingut. Për këtë kërkoi që te jepet një sqarim.

Një shqetësim tjetër e që vlen te theksohet është edhe devijimi i projektit të rrugës “B”, kur dihet se ajo rrugë ka qenë e projektuar ne vij të drejtë. Kërkoi arsyen për ndryshimin e saj.

Çështje tjetër është se afër shkollës së mesme “ Xhin Gazuli” është ndërtuar një shtëpi e cila ka leje të ndërtimit, por është ndërtuar ne mes të rrugës dhe si pasojë e kësaj është bllokuar ajo pjesë e banorëve. Lidhur me këtë çështje, **kryesuesi** tha se ajo pjesë është dërguar për shpronësim dhe se ky problem pritet qe te zgjidhet se shpejti.

*Mbledhja mbaroi në orën 17:00.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**